



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 82 paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, nenit 53 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative nr.05/L-031, neneve 14, 15 paragrafi 2.4, dhe nenin 90 paragrafët 2 dhe 3 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, sipas Shkresës nr.5261-2/24 datë 03.09.2024 dhe Shkresës rivlerësuese/rishqyrtuese nr.6559-2/24 datë 17.01.2025 të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, pas rishqyrtimit të aktit, në kërkesë të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në mbledhjen e mbajtur më 29 janar 2025, mori këtë,

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim anulohet *Vendimi i Kuvendit të Komunës nr.prot.01-350/01-0050259/24 datë 31.07.2024 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1.*

Neni 2

- Arsyeja e anulimit sipas nenit 1, është për shkak se Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës fillimisht ndër të tjera ka vlerësuar se “*përshkrimi i tekstit është konfuz dhe i paqartë nëse Plani në fjalë parashihet apo jo në dokumentet e planifikimit hapësinor, dhe se raporti i arsyeshmërisë duhet të punohet në bazë të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.01/2018, si dhe duke kërkuar që vendimit t’i bashkëngjitet ekstrakti nga dokumenti i planifikimit hapësinor në fuqi ku parashihet hartimi i këtij Plani*”.

Gjithashtu pas komunikimeve dhe kërkesës së Komunës për rivlerësim të aktit, Ministria e cekur ndër të tjera ka kërkuar që “*vendimi në fjalë duhet të plotësohet në preambulë me nenet 5, 6, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.01/2018, vendimit t’i bashkëngjitet ekstrakti nga dokumenti i planifikimit hapësinor në fuqi, si dhe raporti i arsyeshmërisë të punohet sipas neneve 6 dhe 7 të këtij Udhëzimi Administrativ*”.

- Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Podujevës, me qëllim të iniciimit të ri procedural merr përsipër përgatitjen e dokumentacionit dhe procedimin në Kuvendin e Komunës në një afat sa më të shkurtër të mundshëm dhe atë konform vlerësimeve dhe rekomandimeve të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si dhe konsultimeve paraprake me këtë Ministri.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren 06/2021 si dhe Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave.

Nr.Prot. 01-016/01-0006462/25
Podujevë, datë; 29 janar 2025

